



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 94/2017

Prishtinë, më 12.4.2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Sasha Milosavljeviq, zëvendëskryetar i dytë, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Rustem Berisha dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Glauk Konjufca, zëvendëskryetar i parë, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca dhe Enver Hoti, anëtarë.

I ftuar: Petrit Gashi, kryesues i Bordit të Drejtorëve në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Pjesëmarrës të tjerë: Ekrem Hajdari, Bajram Zejnullahu dhe Adem Selishta – AKP; Etleva Malushaj – LVV; Dardan Abazi–INDEP; Fjolla Uka – KDI; Mirgjin Zhubi- GLPS; Kaltrina Zymberi- Ekonomia online; Sylejman Blaku – Kosova Sot; Kaltrina Rexhepi– BIRN; Kushtrim Ahameti – KTV; dhe Ismail Shabani –Kosova Press.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina, Veton Raci dhe Nuri Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1.Miratimi i rendit të ditës;**
- 2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 5.4.2017;**
- 3.Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit - AKP-së për vitin 2016;**
- 4.Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 5.4 .2017

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 5.4.2017, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit - AKP-së për vitin 2016

Kryetari tha se Komisioni e ka pranuar Raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2016, lidhur më këtë e kemi të ftuar z. Petrit Gashin, kryesuesin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së të cilit ia dha fjalën për të prezantuar raportin.

Petrit Gashi, kryesues i Bordit të Drejtorëve në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, tha se nuk do të raportojë në detaj për raportin, pasi që për këtë çështje është drejtori ekzekutiv i AKP-së, z. Ekrem Hajdari. Ai njoftoi që raporti është përgatitur dhe janë adresuar vërejtjet që kanë qenë nga Komisioni prej vitit të kaluar. Po ashtu, kemi përgatitur edhe një “Strategji Përmbyllëse për Agjencinë Kosovare të Privatizimit”, kjo është një prej dakordimeve që e kemi pasur bashkërisht. Strategjia Përmbyllëse është aprovuar në mbledhjen e fundit të Bordit të AKP-së dhe kjo do të jetë njëfarë udhërrëfyes për të ardhmen e AKP-së.

Ekrem Hajdari, drejtor ekzekutiv i AKP-së, e paraqiti raportin para komisionit në pika të shkurtra në mënyrë kronologjike si vijon: Plotësimi i infrastrukturës nënligjore për mbarëvajtjen e proceseve: janë aprovuar tanimë rreth 30 akte të brendshme normative; shitja e aseteve: çdo muaj, së paku një valë e shitjes, janë realizuar 4 valë të privatizimit me 127 shitje të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve në vlerë totale prej 18.6 milionë euro, deri tani janë inkasuar 661,840,216 euro nga shitja e 1,304 aseteve prej qershorit 2002. Likuidimi i Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH) 36 NSH janë vendosur në likuidim vetëm gjatë vitit 2017, ndërsa 463 tjerat gjatë periudhës 2002-2016. Janë shqyrtuar 89,554 kërkesa kreditore. Janë përgatitur raportet e shpërndarjes së kreditorëve për 124 NSH për gjithsejtë shumë prej 19.6 milionë euro, janë paguar 18 milionë euro, në proces të pagesave edhe 1.6 milion euro. Janë mbyllur 13 NSH me vendimet e Dhomës së Posaçme. Në pritje të ndryshimeve ligjore, për “fondet e mbetura” për t’u transferuar në Buxhetin e Kosovës janë rezervuar 39 milionë euro. Transferimi i Fondeve Tepricë të Qeveria e Kosovës në dhjetor 2015 i janë transferuar Qeverisë së Kosovës mbi 61 milionë euro si fonde tepricë. Gjithsej deri tani janë transferuar 90,244,911 euro. Shpërndarja e 20% për punëtorët e NSH-ve gjatë vitit 2016 rreth 11 mijë punëtorë të 93 NSH-ve kanë përfutur shumë prej 5,728,413 euro. Deri në zgjidhjen e kontesteve gjyqësore mbahen në mirëbesim për shpërndarje edhe 21,121,998 euro. Prej vitit 2002 e deri më 31 dhjetor 2016, shuma e përgjithshme e shpërndarë e 20%-it është 109,973,567 euro për gjithsej 46,002 punëtorë. Lirimi i aseteve të uzurpuara: gjatë 2016 janë liruar 114 asete të uzurpuara. Nga nëntori 2014 e deri më tani janë liruar 438 asete të uzurpuara. Tanimë janë gjithsej edhe 57 asete të uzurpuara, prej tyre 25 asete në veri të Kosovës, 30 toka bujqësore, 2 asete që do të lirohen së shpejti. Kemi rritje të jashtëzakonshme të inkasimit të qirave: gjatë periudhës 2014 -

2016 janë inkasuar afër 13 milionë euro, apo 59% më shumë se sa në total gjatë periudhës 2002 - 2013. Me përkrahjen formale të institucioneve relevante, është bërë aprovimi i qiradhënies së një pjese të pronës së minierës së NSH Goleshi për nevoja të rifillimit të punës në Ndërmarrjen Ferronikeli, rrjedhimisht rreth 900 punëtorë kanë vazhduar punën. Bashkëpunimi me organet qendrore është rritur në funksion të koordinimit të politikave vendimmarrëse që mund të ndikojnë në procesin e privatizimit dhe likuidimit të NSH -ve. Vazhdohen përpjekjet e shumta për ngritjen e efikasitetit të Dhomës së Posaçme në mënyrë që të përshpejtohet përmbyllja e likuidimit të NSH-ve pa vonesa. Bashkëpunimi me organet lokale edhe pse është rritur mbesin ca sfida në ngritjen e bashkëpunimit me disa komuna në Republikën e Kosovës, kryesisht në sigurimin e dokumenteve kadastrale dhe dokumenteve të tjera që mundësojnë kryerjen e mandatit ligjor të AKP-së pa vonesa.

Kryetari tha se nga ky raport dhe nga kontaktet të cilat i kemi pasur prej bisedës që e kemi bërë me juve gjatë vizitës, ne mund të konstatojmë me kënaqësi se puna e bordit dhe menaxhmentit të AKP-së, ka shënuar një konsolidim, ka shtuar dinamikën e punëve, është një punë, pra më e angazhuar dhe më konsistente në funksionet që duhet t'i ketë Agjencia, d.m.th kemi një përshpejtim pas konsolidimit tash ka filluar edhe përshpejtimi i konsolidimit të privatizimit të aseteve dhe të organizatave të pa privatizuara dhe të likuidimit të organizatave të cilat duhet të likuidohen dhe që nuk hyjnë në procesin e privatizimit. Mund të them se është një shembull i mirë i punës, natyrisht që Agjencia i Privatizimit ka qenë i angazhuar me shumë probleme të mëdha duke e përfshirë edhe Trepçën, por edhe probleme të tjera natyrisht që mbeten shumë punë për t'u bërë, por ajo që ne kërkojmë është që ky trend i konsolidimit dhe trend i punës duhet të përshpejtohet dhe duhet të shkojë më tutje kah angazhimi i punës, për arsye se ende kanë mbetur shumë çështje për t'u zhvilluar. Angazhimi i juaj për strategjinë bazë për rumbullakimin e punëve i cili e ka një orientim tri vite likuidimi, katër vjet privatizimi për t'u përmbyll procesi. Mirëpo, ne kemi diskutuar edhe herëve të tjera dhe tash do ta theksoja se kjo meriton një diskutim më të gjerë. Unë mendoj se këtë çështje do ta lëmë për diskutim në një mbledhje të posaçme të Komisionit dhe Kuvendit. Në qoftë se ne e kemi një transaksion vjetor diku 20 milionë në vit shitje dhe diku deri në 50 milionë na kushtojnë shpenzimet e transaksionit të administratës dhe menaxhimit të këtij procesi, atëherë kjo nuk duket të jetë shumë racionale dhe e pranueshme në aspektin shoqëror. Prandaj ne duhet t'i shohim të gjitha situatat të cilat kanë të bëjnë me një përmbyllje racionale dhe me një kostbenefit të arsyeshëm nga aspekti i publik të shpenzimeve edhe efekteve që prodhon kjo agjenci në interesin publik, kështu që unë kisha propozua që sot të mos diskutojmë shumë për këtë material që sollët, që e keni bërë në bazë të konkluzave tona, por propozoj që në mbledhje jo më larg se dy muaj ne ta trajtojmë këtu në komision dhe mandej ta dërgojmë me konkluzione në Kuvend, që kjo çështje të trajtohet atje. Problemet me kërkesat e kreditorëve dhe adresimit të tyre deri të ngadalësimi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme kanë mbetur në të njëjtin nivel. Ne mund të marrim si një shenjë të mirë në qoftë se është shpejtuar, por në qoftë se 13 ndërmarrje hiqen për një vit atëherë sa ndërmarrje kemi? Prandaj pyetja ime e parë është sa vendime ka marrë Dhomë e Posaçme e Gjykatës Supreme gjatë vitit 2016? Atje i kemi, më duket, rreth 22 gjykatës, dhe sa lëndë janë përfunduar brenda një viti në atë gjykatë? Ndoshta duhet pak me na i arsyetuar disa gjëra më vonë. Unë vetëm po i theksoj, një nga një arsyet pse duhet ta diskutojmë edhe çështjen e strategjisë dalëse pak në mënyrë më hollësisht është edhe çështja e tokave bujqësore edhe ne

e kemi dhënë një rekomandim vitin e kaluar, që të kemi një studim se çka është më mirë që të bëjmë me këto toka, a t'i privatizojmë këto me çmim më të ulët apo të krijojmë një agjenci që mund t'i japë me koncesion në interesin publik. Kemi rreth 22 mijë hektarë toka dhe na duhet shohim se si duhet të shkojë çështja. Qiraja e përgjithshme e akumuluar prej fillimit të funksionimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe është diku rreth 20 milionë euro. Mendoj se na duhet ta hapim këtë mundësi që kjo qira mos të jetë më e ngrirë për arsye se s'ka më dilema se pronat shoqërore të Kosovës i kanë takuar Kosovës dhe popullit të Kosovës, atëherë edhe qiraja prej këtyre pronave nuk është më diskutabile. Një çështje tjetër janë asetet e shitura, asetet e pa shitura. Aset mundet me qenë një kamion, aset mundet me qenë një pronë publike që është me qindra miliona e vlefshme, prandaj ndoshta duhet në raport këtë çështje me e pas pak më të qartë. Është mirë që keni filluar me i evidentuar këto asetet apo pronat e Kosovës që janë po ashtu edhe në vende tjera të ish -Jugosllavisë dhe mendoj që kjo është për herë të parë në mënyrë kaq eksplicite e paraqitur edhe pse kjo është një çështje mjaft e ndërlikuar që ndërlidhet me reciprocitetin dhe duhet të shohim se si do të jetë reciprociteti dhe suksesioni. Dhoma e Posaçme Gjykatës Supreme duhet një temë e veçantë të parashtrohet në Kuvend të përgatitët një raport dhe një informim se çka do të bëjmë më këtë situatë, për arsye se nuk mundet shoqëria e Kosovës me këtë dinamik duhen edhe 20 deri 30 vjet me u përmbyll ky proces. Një çështje tjetër mjaft me rëndësi ka të bëjë edhe me përshpejtimin e likuidimit. Ne e kemi atje një kontraktor a i zgjatët atij akoma kontrata dhe po me duket që nuk është ajo dinamikë që është dashur me qenë, duhet me e përshpejtuar atë çështje sepse likuidimi është më i mirë se vijnë mjetet në funksion në buxhet të Kosovës.

Raif Qela: Para së gjithash, mund të them me kuptimin e plotë të fjalës se kjo agjenci ka shënuar përparim në mënyrën e punës së vet, ku edhe raporti e pasqyron atë punë. Raporti është mjaft i detajuar edhe duket se është mjaft korrekt në mënyrën e përpilimit edhe në mënyrën e paraqitjes e të dhënave. Marr në përgjithësi, ky raport mendoj se duhet të pranohet si i tillë dhe të miratohet prej këtij Komisioni. Unë do të ndalesha vetëm në disa çështje të cilat mendoj se raporti është dashtë të merret më shumë edhe në rend të parë, siç e përmendi edhe kryetari i Komisionit, lidhur me dhomën e posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet të cilat kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Do të doja mendimin e juaj se si kjo çështje të mos mbetet fyt i ngushtë për zgjedhjen e konteksteve pronësore, por të jepni edhe ju propozimin tuaj se si e shihni edhe ju rrugëdaljen prej kësaj situate. Jam i kënaqur me atë se hapat të cilat i ka ndërmarrë Agjencia Kosovare e Privatizimit edhe për lirimin e uzurpimeve, edhe për dhënien me qira të parcelës në Golesh që ka çelur udhën që Feronikeli ta vazhdojë punën, edhe pse ju keni mundur, po të përpiqeshit, që ta zbatoni në mënyrë të ngurtë Ligjin e ta vononit këtë proces. Ju keni kontribuar që ky proces të përshpejtohet, prandaj për këtë ju përgëzoj. E vetmja çështje që është dashur ta trajtoni më seriozisht, edhe pse mendoj se ka vend edhe të debatohet, është lidhur me studimin e fizibilitetit për Trepçën në orientim strategjik për zhvillimin e saj. Agjencia Kosovare e Privatizimit e ka përgatitur dosjen e tenderit edhe, në përputhje me të, një operator është në përfundim të këtij studimi të fizibilitetit. Prej krejt asaj çka unë kam parë edhe përfunduar, në përputhje me të dhënat që i kam, edhe nga një pjesë e madhe e ekspertëve që i kanë analizuar këto çështje, del se ky studim i fizibilitetit nuk është për të qenë. Mendoj se nuk janë mjaft profesionalë në punën e tyre. Ka vend në debat lidhur me këtë, meqenëse nuk është punë e kryer dhe është problem të thuhet me saktësi se si do të përfundoj kjo çështje, po ndalem

vetëm tek disa prej tyre. Gjuha e përdorur është shpeshherë joprofesionale, me terma jo shkencore, mungesë e njohjes së gjendjes reale, përderisa vetë kompania nuk ka pasur mundësi dhe nuk ka bërë as hulumtime të mëtutjeshme edhe i ka shfrytëzuar të dhënat të cilat janë grumbulluar nga ekspertë vendorë me dekada të tëra. Në fund del se po ato të dhëna i ka minimizuar në kundërshtim me atë se si është gjendja në terren. Deri më tani në një farë mënyre është përdorur sistemi rus i klasifikimit me kode të tjera dhe tash në kode të raportimit CRIESCO del që prej 62 milionë tonë të konstatuara; në një farë mënyre tani del se janë 35 milionë tonë të rezervave të balancuara të minuara. Në të gjitha minierat shihet përpjesëtimi i tyre në minierën e Stantërgut është nga 22 milionë rezerva gjeologjike konvertohen në 12 milionë rezerva minerale të balancuara, ndërsa në minierën e Bellobërdo është përafërsisht po ashtu edhe ajo në minierën në Černac po ashtu: i bie se janë bërë kritere të ndryshme për miniera të ndryshme në konvertim të burimeve të xeheve. Edhe autori i kësaj ka thënë se për përgatitjen e studimit të fizibilitetit, autori duhet të shpenzojë 3.5 % të kostos totale të projektit edhe ky konstatim është edhe vetë në këtë draft të fisibilitetit, ndërsa kjo kompani nuk ka bërë hulumtime të tjera dhe i ka marrë krejt të gatshme.

Muhamet Mustafa: z. Raif, ne nuk i kemi këto në raport nuk po e di se ku i keni marrë ju këto të dhëna dhe nuk i kemi sot në diskutim?

Raif Qela: Është i lidhur ngushtë me këtë: Dosja e tenderit është përgatitur nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, ju lutem, përderisa edhe një javë është afati për raportin e fundit që këto rezultate të përmbyllen; dhe kjo i bie që në qoftë se përmbyllen keq Kosova, ka pasoja nga kjo, sepse konstatohen se ka rezerva më pak se sa ka në të vërtetë dhe si pasojë e kësaj mund të kemi dëme afatgjata. Tjetra, në fund fare, është lidhur edhe me synimin që mbetet industriale të paraqiten vetëm si ngarkesë financiare për rehabilitim dhe mirëmbajtje dhe jo si përfitim prej saj, pavarësisht që ka pasur edhe tendenca edhe më herët që kjo të mos vlerësohet kështu. Një e vërtetë është se prej këtyre mbetjeve minerale ka mundësi që të përfitohen disa qindra miliona euro, përkundër faktit që mund të ketë edhe shpenzime për rehabilitim për mirëmbajtje, ndërsa nuk është vetëm ngarkesë financiare; dhe kjo, nëse mbetet e tillë, edhe për këtë është dëm për Kosovën. Meqenëse kjo e gjitha përmbillet brenda javës, megjithatë është e udhës që sado që ne nuk kemi kompetenca t'u përzihemi në punë, megjithatë nëse shihet se nuk është punuar si duhet, t'i shtyni që të punohet si duhet edhe ta përmbyllin si duhet këtë proces, sepse përndryshe mund të ketë pasoja.

Besim Beqaj: Është një raport me përmirësime teknike nga hera e kaluar dhe nuk kisha me thënë që në kuptimin substancial lidhur me gjërat të cilat i kemi diskutuar nuk kemi ndonjë përparim të veçantë dhe unë kam pritur që ato rekomandime që kanë dalë në takimin e fundit do të jenë të prezantuara pak më fuqishëm. Raporti është faktografi me të dhënat statistikore dhe është përshkrues, përshkrues i veprimeve kryesisht administrative të cilat janë marrë, por jo edhe hapave të cilët parimisht AKP-ja në disa raste duhet t'i merr. Herën e fundit kemi diskutuar për ndërmarrjet me “Spin off special” dhe për ndërmarrjet të cilat janë nën monitorim, raporti është i njëjtë për më shumë, në shumicën e rasteve i referohet bordi do ta shqyrtojë raportin do ta bëjë një raport të tillë, por jo diçka konkrete dhe besoj që kjo është një mangësi goxha e madhe, sepse ne duhet të dimë se a i kanë plotësuar apo nuk i kanë plotësuar, a janë në

vijim të plotësimit të tyre, apo nuk janë në plotësim të obligimeve të cilat i kanë marrë. Dhe në bazë të raportimit të cilat i kemi këto nuk janë plotësuar. Çështja tjetër është te shpalosja për Trepçën, ku ne nuk po na jepni asnjë hap të saktë se çka është duke ndodhur brenda AKP-se për Trepçën, e cila është njëra nga asetet më të vlefshme të cilat i ka pasur në menaxhim dhe të cilat duhet të kalojnë, pra sipas Ligjit duhet të jenë në transicion kryesisht tjetër. Por as këtu nuk kemi ndonjë shpjegim i cili do të duhej që do të ishte i saktë sa i përket trajtimit të Trepçës dhe janë të periudhës tranzitore, bile në disa vende i referohen edhe strategjisë për Trepçën e cila sa unë kam informata nuk është aprovuar në një farë forme konsiston si mos me pas qenë e aprovuar. Pra, kjo është një çështje të cilën kisha dashur që ta trajtoni shumë më substancialisht. Ajo që kisha dashtë të dije nga raporti do të ishte të merrni informata për strukturën e madhe që e keni në proces të privatizimit dhe jo vetëm ato që ka qenë në raundin e parë në raundin e dytë. Mirëpo ne, do të duhet ta dinte Kuvendi edhe qytetarët e Kosovës, se cilat struktura të aseteve janë në proces të privatizimit të cilat neve do të na jepnin një target të qartë se kur mundet me u përfunduar si proces. Veprim i cili mbetet për t'u respektuar shumë është lirimi i uzurpatorëve, por se do të ishte edhe konstatimi në raport se a ka hapësira ku duhet me i ditur, edhe hapësirat gjeografike se ku gjinden ato dhe a kemi mundur me e bërë një ndikim në pjesën veriore, apo nuk kemi mundur të bëjmë ndikim në pjesën veriore, sepse dihet se kjo është pikë goxha e ndjeshme. Një çështje tjetër që duhet ta dije nga projeksioni buxhetor, në buxhet të këtij viti janë parapa investime kapitale në shuma të mëdha nga AKP-ja dhe që thatë ju që janë diku rreth 30 e diçka milionë, të cilat janë të përgatitura, por të cilat varen nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme e cila është krejtësisht logjike, dhe ky veprim i ngadalshëm në mënyrë automatike në mos realizimin e investimeve kapitale sepse duke qenë që kam punuar në buxhetin e vitit 2017, ne kemi burime të financimit për projekte të caktuara, të cilat janë të lidhura me AKP-në, për më shumë besoj që ju keni marrë pjesë në hartimin e KASH-it, në tri vitet e ardhshme parashikim për të hyrat nga AKP-ja konsiderohet që të shkohet deri në 150 milionë euro në vit, ku besoj që ju së pari të jeni të kujdesshëm me premtimet të cilat mund të bëhen, sepse kjo mund të ndikojë në mënyrë shumë negative në realizimin e proceseve të investimeve kapitale të cilat varen nga të hyrat të cilat i keni bërë ju dhe duhet ta kuptoni se ato të hyra nuk varen nga ju dhe besoj se nuk është mirë me dhënë konstatime qysh i keni dhënë herën e kaluar.

Rrustem Berisha, pa dashur me i përsërit këto konstatime që i thanë kolegët, unë desha të ju bëj disa pyetje, kur do të mbyllet ky proces i privatizimeve? Kishte me qenë mirë me e pas një datë të caktuar se me të vërtetë u stërgjatë ky proces i privatizimit. Kemi qenë të interesuar me i ditë pak a shumë rreth privatizimit në pjesën Veriore, ju i thatë pak a shumë rreth uzurpimeve janë diku 57 aseteve, në Veri janë 25. A ka ndonjë mundësi që të na i shpjegoni çështjen e trajtimit të tokave bujqësore, sepse vërtet aty po bëhet një gabim tejet i madh, po ju jepet njerëzve, po e privatizojnë atë tokë, nuk po e punojnë, por shumica që e kanë privatizuar me një çmim shumë të lirë edhe realisht nuk po përdoret për çka ish dashur me u përdor.

Petrit Gashi-AKP: Pajtohem me kryetarin se Strategjia dalëse ka nevojë për një trajtim të veçantë, është punuar gjatë në të janë analizuar të gjitha kapacitetet që ne i kemi në dispozicion dhe është ardhur me një orar optimal të përmbylljes të agjencisë, kjo është bërë në bazë të një metodologjie të caktuar. Po ngrihet në vazhdimësi çështja e Dhomës së Posaçme, ne e kemi breng shumë të madhe, është një prej fyteve më të ngushta me krejt procesin. Deputet të

nderuar, duhet që edhe publiku ta ketë parasysh që kjo është një prej hallkave, është pjesë e procesit, por është jashtë agjencisë. Kështu që ne nuk mund të ndërhyjmë në asnjë mënyrë në punën e tyre. U ngrit çështja e trajtimit të tokave, ne kemi marrë njëfarë vendimi si bord që deri sa nuk ta qartësojmë strategjinë që si i trajton tokat bujqësore, të procedojmë vetëm me shitjen ose tenderimin e tokave deri në 5 hektarë. Para pak ditësh kemi pasur një vizitë nga kryeministri me kabinetin e tij dhe kemi trajtuar një numër asetesh, të cilat mund të trajtohen në kuadër të Ligjit për investime strategjike. Në mesin e asteve, që i kemi prezantuar para tyre, janë edhe tokat bujqësore mbi 50 hektarë që janë parcela komplete dhe parcela të shpërndara, por që mund të grupohen në një parcelë të vetme. Sa i përket çështjes së qirave, të cilën ju e ngrihet t'ju them të drejtën ne kemi bërë mjaft shumë avancime, është një formë e ndërmjetme para se ne ti vendosim për shitje këto asete dhe besoj që është shumë e logjikshme që ne t'i japim me qira para se t'i vendosim në shitje. Ne kemi bërë një progres shumë të madh edhe besoj që janë të prezantuara edhe në raportin vjetor, të hyrat e inkasuara në vitet e fundit janë shumëfishuar. Çështja e likuidimit, në këtë proces nuk ka ngecje sa i përket agjencisë, as nuk besoj që ka ngecje as sa i përket kontraktorit që e kemi të obliguar me ligj ta trajtojë procesin e likuidimit, të gjitha proceset në kuadër të procesit të likuidimit janë të trajtuara. Për çështjen e Studimit të Fizibilitetit nuk e di se ka kanë dalë ato informacione, por sa i përket kontraktorit ju them me përgjegjësi të plotë se pa asnjë dyshim në profesionalizimin e tyre nuk do të ketë dhe as nuk ka, sepse i kemi kontraktuar dy kompani me renome ndërkombëtare, prej ma të madhes në botë për me realizuar këtë punë. Të gjitha informacionet të cilat janë të konfirmuara lidhur rezervat janë marrë parasysh, të gjitha informatat të cilat janë informuar prej Trepçës janë marrë prej ekspertëve të Trepçës janë të përfshira në raport pa kurrfarë dileme. Çështjen e rezervave, ka qasje të ndryshme sa i përket mënyrës se si janë përcaktuar sa rezerva janë të konfirmuara. Çështja e mbetjeve është çështje që ne e kemi pasur, ekziston një farë shprese diku që kanë një vlerë të caktuar dhe unë e konsideroj në të vërtetë mund ta konfirmoj që ka interesim edhe për mbetjet, ka edhe një vlerë të caktuar të mbetjeve, por gjithmonë duhet ta kemi parasysh që çfarëdo trajtimi të mbetjeve vjen me një kosto shumë të madhe ambientale. Zoti Beqaj tha se raporti është përshkruar edhe lenë për t'u dëshiruar, më siguri që është përshkruar, por besoj që është edhe mënyra e raportit të tillë, me siguri që ka hapësirë që të jetë më analitik, është shumë e saktë që vitin e kaluar është ngritur prapë çështja e raportimit të "Spin off special". Unë mund të ju informoj tash që ne, gjatë vitit 2017, kemi filluar të merremi me këtë, nuk jam i sigurt që ju jeni të informuar për kompleksitetin e këtyre ndërmarrjeve për problemet që ne, si agjenci ose ne si strukturë e re brenda agjencisë ballafaqohemi në kontekst të këtyre lëndëve. Është ngritur prapë çështja e uzurpatorëve, është e saktë që në pjesën Veriore edhe nuk kemi arritur një rezultat konkret, por jemi në diskutime të vazhdueshme me strukturat me pjesën Veriore me kryetarët e komunave atje. Sa i përket KASH-it prapë dua ta qartësoj një çështje, në asnjë mënyrë asnjëherë agjencia prej që jemi ne si strukturë e re, si bord dhe si menaxhment, nuk kemi dhënë asnjë premtim të as një forme ose çka do që kemi thënë sa i përket numrave transfereve që mund të sigurojmë për buxhetin kanë qenë krejt konservative.

Raif Qelaj, lidhur me qasjen që ka pasur Agjencia e Privatizimit lidhur me Trepçën ka qenë qasje shumë korrekte edhe për këtë ju përgëzoj. Desha të ju pyes lidhur me mbetjet industriale, në këtë draft të studimit të fizibilitetit aty figuron se këtu shihen vetëm si ngarkesë financiare për rehabilitim e mirëmbajtje dhe jo si përfitim, unë nuk i kam shifrat e sakta, por e di se dhjetra miliona euro i ka përfituar Trepça përmes tyre që natyrisht ju ja keni mundësuar që t'i bëjë

shitjen e këtyre mbetjeve industriale. Kurse ju mund të na thoni se sa është sasia dhe vlera shitjeve industriale?

Ekrem Hajdari – AKP: Të dhënat e sakta dihet që ua dërgojmë, ku dihet se sa mbetje janë shitur në secilën periudhë, në kuadër të këtij procesi të fizibilitetit janë marrë parasysh për herë të parë edhe obligimet ligjore sa i përket ruajtjes së ambientit pikërisht të atyre mbetjeve dhe rrezikshmërisë së tyre. Andaj, ky bilanci mes asaj ka sjellë disa shqetësime edhe te kontraktori, këto shqetësime i janë bërë me dije vetë menaxhmentit të Trepçës në shumicën e rasteve. Ne do t'ua përcjellim të dhënat e sakta për të gjitha mbetjet të cilat janë shitur deri më sot, dhe të mos të themi se është shitur kajmaku i këtyre mbetjeve e tash vinë ato ma problematike, të cilat mund të na e paraqesin këtë problemin ambiental.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. *Të miratohet Raporti vjetor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm: AKP), për vitin 2016, me rekomandimet si në vijim:*
 - a) *AKP-ja të kompletojë Strategjinë për përfundimin efektiv të procesit të privatizimit me kosto racionale në interes publik, duke përfshirë edhe çështjen e tokave në pronësi shoqërore, brenda një periudhe të arsyeshme kohore;*
 - b) *AKP-ja duhet të sigurojë kushtet në mënyrë që të hyrat nga qiraja e NSH të derdhen në buxhetin e Kosovës;*
 - c) *AKP-ja të fuqizojë mbikëqyrjen e privatizimeve me “Spinoff special” dhe me kushte të veçanta, si dhe në raportimet vijuese të japë më shumë detaje lidhur me këto privatizime;*
 - d) *Institucionet përkatëse, përkatësisht Ministria e Financave dhe AKP-ja të angazhohen për krijimin e kushteve që fondi i krijuar nga privatizimi të vendoset në funksion të zhvillimit ekonomik;*
 - e) *AKP-ja të vazhdojë procesin e likuidimit të NSH-ve, duke e zbatuar kontratën me operatorin përkatës sipas përmbajtjes dhe dinamikës;*
 - f) *Kuvendi i Kosovës dhe institucionet tjera kompetente ta mbështesin AKP-në të vazhdojë me lirimin e pronave shoqërore të uzurpuara, si dhe me lirimin e të gjitha pronave shoqërore që janë duke u shfrytëzuar në kundërshtim me ligjin.*
2. *Arsyetimin e Raportit me rekomandime, e paraqet kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa.*

4. Të ndryshme **Çështjet vijuese**

Kryetari e njoftoi Komisionin së tani më e kemi edhe përgjigjën e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për çështjen e Postës, por tani kërkojmë edhe një sqarim ligjor nga Departamenti Ligjor i Kuvendit se a kemi të drejtë ta shqyrtojmë si Komision këtë çështje duke marrë parasysh se çështja është në procedurë gjyqësore.

Komisioni e përkrahu propozimin e kryetarit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa